



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

---

Numri i lëndës: 2019:237444  
Datë: 20.02.2024  
Numri i dokumentit: 05395568

**Ac.nr.6718/2021**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Hysni Bardheci-kryetar i kolegjit, Bujar Muzaqi, dhe Enes Mehmeti, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditëses L.B., nga fshati G.P., Komuna Fushë Kosovë, të cilën në bazë të autorizimit e përfaqëson A.K., avokat në Prishtinë, kundër të paditurës K.S. “S.”, me seli në Prishtinë, për kompensimin e dëmit, duke vendosur lidhur me ankesat e të autorizuarit të palës paditëse dhe palës së paditur të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.829/15, të datës 26.04.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 20.02.2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**REFUZOHET** e pathemeltë ankesa e paditëses L.B., nga fshati G.P., Komuna Fushë Kosovë, dhe e të paditurës K.S. “S.”, me seli në Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.829/15, i datës 26.04.2021, **VËRTETOHET**.

**A r s y e t i m**

Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, me aktgjykimin e atakuar, C.nr.829/15, të datës 26.04.2021, ka vendosur si në vijim: “APROVOHET PJESËRISHT SI E BAZUAR, kërkesëpadia e paditëses L.B. nga fshati G.P., Komuna e Fushë Kosovës. I. DETYROHET e paditura K.S. “S.”, në Prishtinë, që paditëses në emër të dëmit jo material dhe material, për shkaktimin e aksidentit me datën 21.01.2015, t’ia paguaj shumat si vijon:

a) në emër të dëmit jo material :

- në emër të dhimbjeve fizike, shumën prej.....1,500.00 euro.
- në emër të frikës, shumën prej.....1,000.00 euro.

b) në emër të dëmit material :

- në emër të ushqimit të përforcuar.....70 euro.

- në emër të ndihmës dhe kujdesit të huaj.....70 euro.
- në emër të dëmtimit të automjetit ..... 2,963.00 euro.

II. DETYROHET e paditura K.S. “S.”, në Prishtinë, që paditëses si ne pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, t’ia paguaj me kamatë ligjore prej 8% për dëmin jomaterial nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi me datën 26.04.2021, ndërsa për dëmin material nga data e paraqitjes së padisë në gjykatë me datë 07.04.2015 e deri në pagesën definitive, për pjesën e gjykuar të kompensimit, si dhe shpenzimet e procedurës në shume prej 794.00 € të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së aktgjykimit.

III. REFUZOHET SI E PABAZUAR pjesa e kërkesëpadisë së paditëses, në emër të dëmit material, mbi shumat e gjykuara dhe atë për: ndihmën dhe kujdesin e huaj shumën prej 130 euro, për ushqimin e përforcuar shumën prej 130 euro, dhe për shpenzime të rehabilitimit fizioterapeutik shumën prej 200 euro”.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor kanë paraqitur ankesë:

I autorizuari i paditëses për shkak të konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovojë ankesën si të bazuar, të ndryshojë aktgjykimin e atakuar në drejtim të rritjes së shumës së kompensimit, kamatës ligjore dhe shpenzimeve të procedurës.

I autorizuari i të paditurës për shkak të shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovojë ankesën si të bazuar, të prishë aktgjykimin e atakuar dhe çështja të kthehet në gjykatën e shkallës së parë në rishqyrtim dhe rivendosje.

Gjykata e Apelit i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 194, 195, dhe 200 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa e paditëses dhe e të paditurës janë të pa pathemelta.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja përmes përfaqësuesit të autorizuar, me datë 07.04.2015, në Gjykatën Themelore në Prishtinë, ka paraqitur padi kundër të paditurës, për kompensimin e dëmit material dhe jomaterial të shkaktuar në aksident komunikacioni të datës 21.01.2015. Në referatin e padisë ka parashtruar së paditësja në këtë aksident ka qenë në cilësinë e drejtuesit të automjetit B, dhe e njëjta ka pësuar lëndime trupore si dhe dëmtime të konsiderueshme në automjetin e saj, ndërsa automjeti A shkaktar i aksidentit në momentin e shkaktimit të aksidentit ka qenë i siguruar tek e paditura, sipas policës së sigurimit nr.0005206061. Pas nxjerrjes së provës me ekspertizë mjekësore nga lëmia e ortopedisë dhe psikiatrisë, si dhe me ekspertizë të makinerisë dhe të komunikacionit, përmes parashtrësës së datës 16.02.2021, e ka precizuar lartësinë e kërkesëpadisë, ashtu që ka kërkuar që të miratohet në tërësi si e bazuar kërkesëpadija e paditëses dhe të obligohet e paditura që paditëses në emër të

kompensimit të dëmit jomaterial dhe material për shkak të aksidentit të datës 21.01.2015, t'ia paguaj shumat si në vijim: për dhimbje fizike shumë prej 1,500.00 €, për frikë shumë prej 1,000.00 €, për ndihmën e huaj 200.00 €, për ushqim të përforcuar 200.00 €, për rehabilitim fizioterapeutik dhe klimatik 200.00 €, për dëmtimin e automjetit 2,963.00 €, gjithsej shumë prej 6,063.00 €, me kamatë në lartësi prej 12% duke filluar nga data e paraqitjes së padisë e deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 898.00 €, në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit të aktgjykimit e nën kërcënim të përmbarrimit me dhunë.

Gjykata duke vepruar sipas padisë dhe kërkesëpadisë së precizuar të paditëses, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse, si dhe vlerësimit të gjitha shkresave tjera të lëndës, ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar me numër C.nr.829/15, të datës 26.04.2021, me të cilin e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e paditëses, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të administruara, ka konstatuar së shkaktar i aksidentit të komunikacionit në të cilën paditësja kishte pësuar lëndime trupore dhe dëm material në automjet, është drejtuesi i automjetit të tipit “VW Golf V”, me targa të regjistrimit Police 091-03, i siguruar tek e paditura, i cili duke lëvizur në rrugë në drejtim të Prishtinës me alarm të ndezur, me të arritur në udhëkryqin e “BBC”, kishte kaluar në semafor të kuq dhe si rezultat i kësaj kishte goditur me pjesën e përparme të anës së djathtë automjetin me të cilën lëvizte paditësja. Këtë konstatim gjykata e ka mbështetura në mendimi dhe konstatimi i ekspertit të komunikacionit të datës 15.09.2020, të përpiluar nga eksperti B.A., përmes të cilës është vërtetuar se shkaktar i aksidentit ka qenë drejtuesi i automjetit i siguruar tek e paditura, i cili gjatë lëvizjes me automjetin në intervenim, duke mos pasur kujdes të shtuar (drita e kuqe në semafor), përgjatë udhëkryqit të rregulluar me sinjalizim ndriçues, i njëjti me pjesën e përparme të anës së majtë e godet automjetin “B” në pjesën e përparme të anës së djathtë, kësaj drejtuesi i automjetit “A” ka shkaktuar aksident në komunikacion rrugor. Sa i përket dëmit material të shkaktuar si pasojë e dëmtimit të automjetit, gjykata përmes ekspertizës së makinerisë të datës 14.09.2020, të përpiluar nga eksperti B.A., ka vërtetuar së vlera e përgjithshme e dëmit në automjetin “Renault Clio” në kohën kur ka ndodhur dëmi në automjet ka qenë 2,963.00 euro. Gjykata me rastin e caktimit të lartësisë për shpërblimin e dëmit jo material për shkak të dhimbjeve fizike dhe frikës së përjetuar nga e paditura, dhe material për ndihmë dhe kujdes nga personi i tretë dhe ushqim të përforcuar, ka vendosur duke marrë për bazë ekspertizat mjekësore të dhënë nga ekspertet mjekësor Dr.A.F. – Ortoped-Traumatolog, dhe Dr.S.G.B. – Psikiatër, ku gjykata përmes këtyre ekspertizave ka vërtetuar faktin së paditësja në aksidentin e komunikacionit të datës 21.01.2015, ka pësuar lëndime të lehta trupore, ku në emër të dhimbjeve fizike ka aprovuar kërkesën në shumën prej 1,500.00 euro, si një shpërblim të drejtë dhe që i shërben qëllimit të shpërblimit, sepse sipas mendimit të ekspertit mjekësor, paditëses në momentin e lëndimit i është shkaktuar përdredhje e unazave të qafës prandaj ky konsiderohet si lëndim i lehtë trupor. E njëjta ka përjetuar dhimbje fizike të intensitetit të lartë në kohëzgjatje prej 48 orë, dhimbje fizike të intensitetit të mesëm në kohëzgjatje prej 15 ditë për shkak të dhimbjeve që ka pas si pasojë e dhimbjeve në qafë për çka paditësja ka mbajtur qafore. Dhimbje fizike të intensitetit të ulët vazhdojnë ende kohë pas kohe sidomos me ndryshimin e kushteve klimatike. Gjykata e shkallës së parë e ka caktuar këtë shumë të kompensimit duke u

bazuar në natyrën e lëndimit, pasojat dhe intensitetin e dhimbjeve. Në emër të frikës së përjetuar gjykata ka caktuar shpërblimin në shumë prej 1,000.00 euro, dhe e ka vlerësuar si shpërblim të drejtë, duke u nisur nga fakti se sipas mendimit të ekspertit mjekësor, e dëmtuara ka përjetuar frikë primare në momentin e aksidentit që ka zgjatë për disa sekonda dhe që është përcjellë me frikë nga vdekja, dhe kërcënimi direkt për integritetin e saj trupor, frikë sekondare të intensitetit të lartë për 48 orë, që është manifestuar me simptome të ankthit të gjeneralizuar, frikë nga invaliditeti, frikë nga procedurat mjekësore, çrregullime gjumi, rikujtime të shpeshta të ngjarjes, çrregullim disponimi dhe ankesa të shulëta somatike, frikë sekondare të intensitetit të mesëm dhe më të ulët e cila ka zgjatë për 2 deri në 4 muaj dhe është ende e pranishme, e manifestuar me reagime emocionale të karakterit ankioz, lodhje në angazhimet minimale, zgjime të herë pas hershme gjatë gjumit me rikujtime të ngjarjes traumatike, e sidomos ka probleme me koncentrim dhe vëmendje si dhe kokdhimbje të shprehura. Për përkujdesjen e personit të tretë, gjykata ia ka njohur shumë prej 70.00 euro, duke vlerësuar se përkujdesja e personit të tretë ka qenë e nevojshme për 15 ditë, për shkak të mbajtjes së qafores dhe pa mundësisë së kryerjes së higjienës personale. Ushqimi ka qenë i nevojshëm për 15 ditë, ushqim i pasur me vitamina, proteina dhe minerale, për çka gjykata ia ka njohur shumë prej 70.00 euro. Sa i përket kompensimit të dëmit material në pjesën e aprovuar të kërkesës së paditëses që ka të bëjë me ushqimin e përforcuar dhe ndihmën e personit të tretë, gjykata e shkallës së parë është bazuar në mendimin e ekspertëve mjeko-ligjor të cilët kanë bërë ekzaminimin e drejtpërdrejtë të paditëses e po ashtu edhe të shikimit të tërë dokumentacionit mjekësor që i janë bashkangjitur shkresave të lëndës – provave si dhe kanë dhënë vlerësim profesional të cilën ekspertizë gjykata e ka marr për bazë gjatë vendosjes në lidhje me kërkesëpadinë e paditëses, sa i përket lartësisë së dëmit jo material duke vlerësuar se shumat e gjykuar do të paraqesin një satisfaksion real për dhembjet fizike dhe frikën e përjetuar. Gjukata e ka refuzuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditëses, si në pikën III të dispozitivit të aktgjykimit të atakuar, pasi që ka vlerësuar se kompensim përtej shumës së gjykuar nuk do të ishte në harmoni me të mirën e shkelur dhe me qëllimin që kompensimi të ishte i drejtë.

Gjukata e shkallës së parë, lidhur me bazën juridike të kërkesëpadisë dhe lartësinë e kërkesëpadisë, vendosi duke u mbështetur në dispozitat e nenit 136, 169, 179 dhe 183 të LMD-së. Lidhur me kamatën, gjykata ka vendosur duke u mbështetur në dispozitat e nenit 382 par.2 LMD-së, ndërsa vendimin për shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 449, 452 dhe 463 të LPK-së.

Gjukata e Apelit të Kosovës, nisur nga kjo gjendje e çështjes, vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjukata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit nuk qëndron pretendimi ankimor i të paditurës së aktgjykimi i atakuar është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore për të cilat pretendon pala ankuese. Aktgjykimi nuk është i përfshirë në të meta për shkak të cilave nuk mund të ekzaminohet dhe në lidhshmëri me këtë dispozitiv i aktgjykimit

është i qartë dhe arsyetimi përmban arsye të mjaftueshme për të gjitha faktet vendimtare, të cilat janë marrë në vlerësim nga gjykata e shkallës së parë, e sipas të cilave edhe është vendosur lidhur me themelësinë e kërkesëpadisë. Në këtë kontekst në arsyetim të aktgjykimit janë dhënë arsye të duhura për mënyrën e vërtetimit të fakteve, për provat e administruara dhe për vlerësimin e tyre sa i përket besueshmërisë dhe fuqisë provuese të tyre. Gjykata në arsyetim të aktgjykimit të atakuar ka paraqitur arsye mjaftueshme në lidhje me bazën e kërkesëpadisë dhe lidhur me lartësinë e dëmit jo material dhe material, si dhe ka dhënë arsye të mjaftueshme për shumat e aprovuara për llojet e dëmit dhe format e tij të kërkuara nga paditësja.

Gjykata e Apelit vlerëson se janë të paqëndrueshme pretendimet e ankimore të paditurës për vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, pasi që gjykata e shkallës së parë drejtë dhe në mënyrë të plotë e ka vërtetuar gjendjen faktike, ku baza juridike e kërkesëpadisë sa i përket shkaktarit të aksidentit është vërtetuar në bazë të ekspertizës së komunikacionit të datës 15.09.2020, të përpiluar nga eksperti gjyqësor B.A., i cili pas analizimit të shkresave të lëndës ka ardhur në përfundim së drejtuesi i automjetit “A”, i siguruar tek e paditura është shkaktar i aksidentit të datës 21.01.2015, ndërsa drejtuesi i automjetit “B”, këtu paditësja nuk ka lëshime në këtë aksident, të cilës ekspertizë edhe kjo gjykatë ia fali besimin pasi që e njëjta është hartuar në mënyrë profesionale dhe është e argumentuar. Ndërsa lartësia e kërkesëpadisë për dëmit jo material për shkak të dhimbjeve fizike dhe frikës së përjetuar nga e paditura, dhe material për ndihmë dhe kujdes nga personi i tretë dhe ushqim të përforcuar, është vërtetuar duke marrë për bazë ekspertizat mjekësore të dhënë nga ekspertet mjekësor Dr.A.F.–Ortoped-Traumatolog, dhe Dr.S.G.B.–Psikiatër, të cilët në bazë të raporteve mjekësore dhe ekzaminimit të drejtpërdrejtë të paditëses kanë konstatuar qartë natyrën dhe llojin e lëndimeve trupore, kohëzgjatjen dhe intensitetin e dhimbjeve fizike dhe të frikës, kohëzgjatjen e nevojës për ndihmën e huaj dhe ushqimin e përforcuar, andaj edhe kjo gjykatë vlerëson se konstatimet e ekspertëve janë profesionale dhe me sqarime të mjaftueshme, për tu vërtetuar format e dëmit dhe lartësia e tyre, ku në bazë të këtyre konstatimeve gjykata edhe ia ka gjykuar shumat për format e dëmit material dhe jomaterial. Kurse për dëmin material të shkaktuar në automjet gjykata është bazuar në ekspertizën e makinerisë të datës 15.09.2020, i cili ka ardhur në përfundim së vlere e përgjithshme e dëmit në automjetin e paditëses “Renault Clia”, në kohën kur ka ndodhur dëmi në automjet është në shumë prej 2,963.00 euro, të cilës gjykata ia ka falur besimin e plotë. Për me tepër, për mënyrën e vendosjes sa i përket dëmit material në automjet nuk ka pasur pretendime ankimore nga asnjëra palë, por pretendimet janë paraqitur sa përket vërtetimit të gjendjes faktike në lidhje me vendosjen për lartësinë e kërkesëpadisë për dëmin jomaterial dhe material të pësuar nga paditësja për shkak të lëndimeve trupore.

Gjykata e Apelit i ka refuzuar pretendimet ankimore të paditëses dhe të paditurës dhe e ka vërtetuar aktgjykimin e shkallës së parë, duke konsideruar se e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë në bazë të gjendjes së vërtetuar faktike ashtu që ka vlerësuar se shumat e gjykuara nga gjykata e shkallës së parë për dëmin jomaterial për shkak të dhimbjeve fizike dhe frikës dhe dëmit material për ushqim të përforcuar dhe për ndihmë dhe kujdes të huaj janë në proporcion me të mirën e shkelur dhe qëllimin e kompensimit që është një lloj satisfaksioni për palën e dëmtuar që sado pak t`ia zbusë dhimbjet e përjetuara për dëmin e pësuar, e duke pasur parasysh edhe moshën e saj në momentin e aksidentit, por duke u kujdesur

njëkohësisht që të mos dëmtohet edhe pala tjetër në këtë rast e paditura. Sipas nenit 136 par.1 të LMD-së është paraparë së “*Kush i shkakton tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij*”. Tutje neni 137 të LMD-së, përcakton se: “*Dëmi është zvogëlimi i pasurisë së dikujt (dëm i zakonshëm) dhe pengimi i rritjes së saj (fitimi i humbur), si dhe shkaktimi tjetrit i dhembjes fizike, vuajtjes psikike ose frikës (dëmi jo material)*”. Ndërsa në nenin 159 par. 1 i LMD-së, është paraparë së: “*Në rast aksidenti të shkaktuar nga mjete motorik në lëvizje që është shkaktuar vetëm për faj të një zotëruesi zbatohen rregullat mbi përgjegjësinë në bazë të fajësisë*”. Në nenin 179 par.1 të LMD-së, është paraparë së “*Kush i shkakton tjetrit lëndim trupor ose ia dëmton shëndetin ka për detyrë të shpërblejë shpenzimet rreth mjekimit dhe shpenzimet tjera të nevojshme lidhur me këtë, si dhe fitimin e humbur për shkak të paaftësisë për punë gjatë kohës së mjekimit*”. Kurse me dispozitën e nenit 183 par.1 dhe 2 të LMD-së përcaktohet se: “*Për dhembjet e pësuar fizike, për dhembjet e pësuar shpirtërore për shkak të zvogëlimit të aktivitetit jetësor, të shëmtimit, të cenimit të autoritetit, të nderit, të lirive ose të të drejtave të personalitetit, të vdekjes së personit të afërm, si dhe frikës, gjykata, po të konstatojë se rrethanat e rastit sidomos intensiteti i dhembjeve dhe i frikës dhe zgjatja e tyre e arsyetojnë këtë, do të gjykojë shpërblimin e drejtë në të holla, pavarësisht nga shpërblimi i dëmit material si dhe nga mungesa e dëmit material. Me rastin e vendosjes për kërkesën mbi kompensimin e dëmit jo material si dhe mbi shumën e kompensimit të tij, gjykata do të ketë parasysh për rëndësinë e shkeljes së të mirës dhe të qëllimit të cilit shërben ky kompensim, e gjithashtu edhe për faktin se me të mos u shkojë përshtat synimeve që nuk janë të përshtatshme me natyrën e saj dhe me qëllim shoqëror*”. Gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ngase konsideroi se shumtë e gjykuara nga gjykata e shkallës së parë janë proporcionale me lëndimet të cilat i ka pësuar paditësja në aksident dhe të gjitha rrethanave tjera të cilat janë më rëndësi për vlerësimin dhe caktimin e kompensimit, e me të cilat do të arrihej qëllimi i kompensimit të drejtë i dëmit të pësuar në aksidentin në komunikacion, e duke u bazuar në ekspertizat mjekësore, ndërsa shumtë e gjykuara për dëmin material e ka bazuar në ekspertizat mjekësore të ekspertëve, të cilët kanë konstatuar se paditësja ka pasur nevojë për ndihmën e huaj dhe ushqim të përforcuar, e që këto forma të dëmit njihen edhe nga kompanitë e sigurimeve dhe janë të pranuar nga praktika gjyqësore, e të cilat forma të dëmit pranohen edhe pa u arsyetuar me fatura, sepse zakonisht për personat e lënduar kujdeset anëtari i familjes, ndërsa ushqimi i përforcuar zakonisht nuk mund të ndahet nga ushqimi i zakonshëm, prandaj këto forma të dëmit pranohen nga gjykatat, duke u bazuar në ekspertizat mjekësore të cilat konstatojnë nevojën dhe kohëzgjatjen për këto forma të dëmit.

Gjykata e shkallës së parë për shumtë e gjykuara ka caktuar kamatën e cila për dëmin jomaterial fillon të rrjedh nga data e nxjerrjes së aktgjykimit, ndërsa për dëmin material nga data e paraqitjes së padisë, gjë që është në pajtim me të drejtën materiale në këtë rast nenit 382 të LMD-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është vlerësuar se është në përputhje me veprimet e ndërmarra në këtë çështje juridike kontestuese, dhe në përputhje me tarifën për përcaktimin e lartësisë se shpenzimeve dhe në pajtim me dispozitat e nenit e neni 449, 452 dhe 463 të LPK-së.

Gjykata e Apelit i shqyrtoi të gjitha pretendimet tjera ankimore të palëve ankuese, por që nuk kishin ndikim për të vendosur ndryshe, për çka vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga arsyet e cekura Gjykata e Apelit, gjeti së gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike, andaj në mbështetje të dispozitave nga neni 194 dhe 195 paragrafi 1 pika (d) e lidhur me nenin 200 të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË  
Ac.nr.6718/2021 me datë 20.02.2024

Kryetar i kolegjit, Gjyqtari  
Hysni Bardheci